

MUHARREM DEZHGIU

**LITAJT GJATË PUSHTIMIT ITALIAN TË SHQIPËRISË
(1939-1943)***

Agresioni ushtarak italian kundër Shqipërisë më 7 prill 1939 shënoi fillimin e pushtimit të saj. Pushtimi i Kukësit më 14 prill do të shënonte pushtimin e gjithë Shqipërisë, e cila zotërohej tashmë nga ushtria pushtuese italiane¹.

Zbarkimi i trupave ushtarake italiane u shoqërua me ndërmarrjen e masave organizative e politike, për të siguruar ruajtjen e rendit publik dhe për t'i prerë rrugën anarkisë. Për këtë qëllim u urdhërua nga komanda e lartë e trupave italiane të vendoseshin bërthama ushtarake për ruajtjen e fortifikimeve në pika të rëndësishme të sigurisë, ndërmjet të cilave ishte dhe Kukësi. Ky i fundit do të ishte një nga qendra e komandave të divizioneve italiane të sjella në Shqipëri.

Nga ana tjetër, nga Komandanti i Trupekspeditës, Alfredo Guxoni, më 10 prill, ishte lëshuar urdhri për të gjitha trupat, repartet e shërbimet vartëse për bashkëpunimin me autoritetet dhe institucionet shqiptare². Në urdhër shtroheshin detyra për zgjidhjen e detyrave që ngjallnin besimin tek shqiptarët, për rifillimin e punës, për funksionimin e bankave, për sigurimin e ushqimit për popullsinë etj.

Të gjitha këto masa, natyrisht ishin në interes të pushtuesit për të realizuar vendosjen e pushtimit me sa më pak tronditje sociale, duke evituar në maksimum rritjen e qëndresës së shqiptarëve kundër tij.

Për të zbehur jehonën ndërkombëtare të agresionit italian kundër Shqipërisë, Mussolini e organizoi manovrën propagandistike në dy drejtime:

Së pari, ai u përpoq ta maskonte agresionin, duke e paraqitur si një domosdoshmëri të natyrshme, për të shpëtuar popullin shqiptar.

* Kumtesë e mbajtur në konferencën me temë "Litajt në histori", organizuar nga Instituti i Historisë, shtator 2008.

¹ *Arkivi i Shtabit Madhor të Ushtrisë Italiane* (më tej: *US. SMEI*) *Occupazione d'Albania* (aprile 1939-agosto 1939). Corpo Spedizione Albania. Shënime ditore lajmesh për Duçen, 14 prill 1939.

² *US. SMEI*, *Diario Storico*, B. 154; fasc. 9. *Diario del 1° Reggim. Bersaglieri* (6-20 aprile 1939).

Së dyti, ai mori masa të shpejta për të mbuluar çdo gjurmë të veprimeve luftarake dhe për të institucionalizuar pushtimin, për ta përligjur atë, që ai të pranohej nga opinioni ndërkombëtar. Si mbështetje ai pati shtypin në shërbim të tij. Me anën e tij, vuri në qendër të goditjes personin e Ahmet Zogut, i cili kishte qenë pengesa më e madhe, e cila e kishte detyruar Musolinin të ndërmernte veprimin ekstrem, agresionin, për ta nënshtruar plotësisht Shqipërinë.

Akuzat kundër personit të A. Zogut synonin të siguronin një mbështetje sa më të gjerë të pushtuesit brenda vendit, por edhe të përgatisnin terrenin shqiptar, për të pranuar disa grupe të emigracionit politik shqiptar antizogist, si klasë e re drejtuese politike, e cila siguronte mbështetjen e plotë të pushtuesit.³

Rrethanat e brendshme dhe të jashtme të vendosjes së regjimit të pushtimit italian të Shqipërisë, patën, padyshim ndikimin e tyre tek shqiptarët. Ato ndikuan në përcaktimin e qëndrimit të tyre në qëndresën kundër pushtuesit për mbështetjen e drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj tij, si dhe të një qëndrimi indiferent tek disa të tjerë, në vitet e para të pushtimit.

Pas pushtimit të Shqipërisë aktivizohet shërbimi informativ jugosllav nëpërmjet dy zyra në Shkup⁴ dhe në Beograd. Detyra speciale e tyre ishte që të vëzhgohej “propaganda italo-shqiptare në Kosovë dhe veprimtaria politike e parisë kosovare”⁵. Në mënyrë të veçantë këto zyra informative përcillnin çdo lëvizje të parisë nacionaliste shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri, posaçërisht në pjesën kufitare: Gjakovë, Prizren, Kukës dhe Dibër. Ata veçuan si figura antijugosllave disa prej tyre si: Tahir Zajmi, Ali Boletini, Pajazit Boletini, Ali Haxhija, Sali Shabani, Adem Marmullaku, Asim Luzha, Mustafa Derguti, Sulë Hadri, Kadri Saliu, etj., nga Kosova⁶, kurse nga rrethi i Lumës veçoheshin: Osman Lita, Zenel Lita, Sherif Lita, Asllan Zeneli, Muharrem Bajraktari, Destan Rexhepi, Hazis Fetahu, Sef Xheladini etj.

Nga raporti i Armatës III Jugosllave të Shkupit për muajin maj 1939 mësohej: “Fillimisht okupimi i Shqipërisë shkaktoi një revoltë antiitaliane tek shqiptarët në Jugosllavi dhe ngjalli tek ata shpresën e një mbështetje të shtetit jugosllav për ndihmë Shqipërisë. Mirëpo, kur u pa se në Shqipëri erdhën në pushtet disa njerëz me ndikim, urrejtja kundër italianëve filloi të zbehet. Sipas ushtarakëve serbë, ideja për bashkimin e tokave shqiptare ishte paraqitur që në kohën e A. Zogut.

³ *Po aty*, (Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë), B. 522 (Gab.205). Lettere del Duce a Sua Maestro il Re, Sulla Situazione Albanese, 5 aprile 1939.

⁴ *Drzhaven Arhiv na Makedonija-Skopje*, Fondi: Vojno Istoriski Mikrofilm 345 (më tej: DAM-Skopje, F. VII, M. 345) (AM, POV.XH.OBR. Br. 465 1939 godina Skopje).

⁵ *Po aty*, F. VII, M. 346, POV.XH.OB. Br. 4777, 1939, god. Beograd.

⁶ *Po aty*, F. VII, M. 345, POV. Br. 465, 4 maj 1939, Skopje.

Prandaj qeveritarët e Beogradit druheshin se “në një kohë sa më të afërt, në mesin e popullatës shqiptare në Jugosllavi do të fillonte një propagandë më e gjallë, se sa ka qenë deri tani, duke patur parasysh se këtë aksion (të bashkimit), pa mëdyshje, do ta ndihmonte moralisht e materialisht Italia”⁷.

Duke konstatuar te shqiptarët e zonës ndërkufitare përhapjen e ndjenjave nacionale, si hap i parë i veprimit nga qeveria jugosllave ishte ndërprerja e komunikimit shqiptaro-shqiptar, duke mbyllur “hermetikisht vendkalimet kufitare me Shqipërinë”⁸.

Pas kësaj pushtetarët jugosllavë filluan një aksion të dhunshëm mbi shqiptarët, me qëllim që të bëjnë pastrim etnik të Kosovës dhe të viseve shqiptare në Jugosllavi.

Sipas konstatimeve të komandës ushtarake jugosllave, shqiptarët, në tërësinë e tyre, shikonin tek Italia një forcë të sigurt për realizimin e shpresave të tyre drejt bashkimit të Shqipërisë së Re, “te Italia shohin një forcë të fuqishme, e cila është në gjendje që çështjen e tyre ta realizojë ashtu siç dëshiron ajo”⁹.

Shtabi i lartë ushtarak jugosllav konstatonte se “Shqiptarët janë të pakënaqur me gjendjen e tyre aktuale në Jugosllavi. Ky është një fakt të cilin nuk mund ta mbulojmë ... Marrja e tokës bujqësore shqiptarëve, si dhe të kuptuarit, nga ana e tyre, se ata janë vërtetë elementë të padëshiruar në këto troje, gjithsesi ka ndikuar pozitivisht në zgjerimin e propagandës në favor të Italisë”¹⁰.

Në këtë situatë pakënaqësia e shqiptarëve, vërente Shtabi i Lartë Jugosllav, mund të paralizohet ose me shpërngulje nga territoret e veta ose me plotësimin e kërkesave të tyre materiale e kulturore”¹¹. Rruga e dytë, plotësimi i kërkesave të tyre në pikëpamje materiale kulturore, mund t'i qetësonte përkohësisht shqiptarët, por, në një moment të favorshëm për ta, përsëri ata do të kërkonin bashkimin me Shqipërinë.

Për këtë arsye Shtabi i Përgjithshëm jugosllav konsideroi si nevojë të patjetërsueshme që, shpërngulja e shqiptarëve nga trojet të fillohej sa më parë. Pastrimin etnik të trojeve shqiptare e bënte të njohur raporti mujor i Komandës së Armatës III në Shkup¹². Në këto rrethana, të zbatimit të projekteve jugosllave për pastrimin etnik të shqiptarëve nga Kosova, intelektualë dhe nacionalistë shqiptarë e gjetën të arsyeshme të organizoheshin me çdo kusht, në një organizim të brendshëm shqiptar. Për këtë u parapa krijimi ilegalisht i

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*, F. VII, M. 344, POV.XH.OB. Br. 760-1939 godine, Skopje.

⁹ *Po aty*, F. VII, M. 346, POV, Xh. OB. Br.4881, 1939, fl.1.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *Po aty*.

¹² *Po aty*, F. VII, M.345, POV. XH.OB. Br. 610, maj 1939, Skopje.

strukturave politike e ushtarake në tërë trevat shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia.

Si qendra më të përshtatshme, për kushtet e kohës, u zgjodhën Prizreni dhe Kukësi. Në krye të kësaj “Lëvizje Kombëtare”, sipas burimeve serbe, ishin: Tahir Zajmi, Ali Boletini, osman Lita, Kadri Saliu, Iljaz Agushi, Asim Luzha, Mustafa Dërguti, Zenel bej Strazimiri etj. Shumë shpejt ata organizuan aradha të armatosura ilegale me qendër Kalanë e Dodës. Në krye të këtyre aradheve ishin zgjedhur Osman Lita dhe Tahir Zajmi¹³ ndërsa shumica e ushtarëve vinin nga viset e ndryshme të Kosovës. Për ekzistencën e lëvizjeve të këtyre aradheve ushtarake, njoftonte raporti i Armatës III, në gusht 1939.

Po sipas të njëjtit burim kaçakët shqiptarë e kalonin kufirin nëpërmjet Bjeshkës së Korabit, të Kalasë së Dodës dhe Rekës së Epërme. Me sa duket këtë organizim e bënte Osman Lita.

Në Kosovë një lëvizje e tillë, u iniciua nga Ali Boletini. Lidhjet me Lumën bëheshin nëpërmjet Tafil Boletinit, i vendosur në Lumë dhe me miqtë e tij Osman e Zejnel Lita.

Reagime kundra politikës së dhunshme të qeverisë jugosllave ndaj shqiptarëve në Kosovë pati edhe nga një grup studentësh serbë. Ata, nëpërmjet gazetës së tyre, jepnin pasqyrën e vërtetë të gjendjes së shqiptarëve nën sundimin e Jugosllavisë mbretërore. Duke iu drejtuar ardhacakëve serbë në Kosovë u kujtonin se “Bukën të cilën po hani ... është marrja e kafshatës nga goja të mijëra familjeve të varfëra dhe të përveuajtura shqiptare¹⁴. Grupi i studentëve serbë iu “qante” hallin edhe shqiptarëve të Kosovës, duke u “solidarizuar” me vuajtjet e tyre nga regjimi antipopullor dhe shërbëtorët e tij. “Ne e dimë – thonin ata midis të tjerash – se deri sa të ekzistojnë dhuna mbi ju edhe mbi ne nuk do të jetë mirë”¹⁵. Gjykuar në tërësi nga kjo thirrje e një grupi studentësh të Beogradit, nuk është vështirë të kuptohet karakteri propagandistik i saj. Prapa thirrjes së studentëve serbë qëndronte PK Jugosllave. Propaganda e saj nuk pati efekt tek nacionalistët shqiptarë. Këta të fundit e kishin të qartë, se çfarëdolloj propagande serbe, kishte qëllime të caktuara për ta dëmtuar unitetin kombëtar shqiptar.

Me sa shihet lëvizja kombëtare që gjallonte në krahinën e Lumës, nuk drejtohej nga pushtuesi italian, por ajo lindi si rezultat i dhunës dhe terrorit që ushtronte pushteti jugosllav mbi popullin e pambrojtur shqiptar në Kosovë.

Në ballë të kësaj lëvizjeje ishin personalitete të shquara si Osman Lita, Tafil Boletini, Tahir Zajmi etj., të cilët kishin kontribuar në vazhdimësi për ruajtjen dhe zhvillimin e Shqipërisë së pavarur. Për këtë arsye shërbimi informativ serb ndiqte këmba-këmbës veprimtarinë e tyre. Në fillim të janarit

¹³ *Po aty*, F. VII, M.345, POV.XH. OB. Br. 935, 1939, Skopje.

¹⁴ *Po aty*, F. VII, M. 346, POV. XH.Br. 9231, juni 1939, Beograd.

¹⁵ *Po aty*.

1940 komanda e xhandarmërisë serbe të rajonit të Vardarit njoftonte se: krerët nacionalist lumjanë Imerr Miftari nga Surroi, Destan Rexhepi nga Bicajt, Osman Mustafa Lita nga Kalaja e Dodës, Asllan Zeneli nga Gjostili, Aziz Fetahu nga Noget dhe Sef Xheladini nga Ujmishti kanë udhëtuar për Tiranë dhe nuk janë kthyer akoma¹⁶.

Në njoftimin tjetër, të muajit shkurt 1940 përmendet krahas Asllan Zenelit etj., dhe emri i Zenel Litës, kapidan nga Kalaja e Dodës¹⁷, që ndodheshin në Tiranë.

Vajtja dhe qëndrimi i Litajve në Tiranë, sipas njoftimit të mësipërm, lidhej me pritjen e Muharrem Bajraktarit, i cili u kthye nga internimi. Me ndihmën e krerëve lumjanë ai vendoset në Lumë, duke krijuar çetat e armatosura shqiptare, jashtë kontrollit të autoriteteve fashiste italiane.

Sa përmendëm më sipër, në vitet e para pas pushtimit italian Litajt ishin të rreshtuar në lëvizjen kombëtare në mbrojtje të tokave shqiptare nga pushtuesi, në veçanti atij serb. Veprimin e synimin e këtyre forcave kaçake, në të cilin mobilizohen shumë anëtarë të familjes Litaj, komanda ushtarake jugosllave e paraqiste si një rrezik, që, sipas saj, “në momentin e duhur do të vepronin në hapësira të gjera. Flitet se ky aksion do të përqendrohet edhe kundra shtetit tonë (Jugosllav). Organizimin e këtyre forcave e udhëheq ish-togeri i Shqipërisë Sherif Lita”¹⁸.

Ky informacion i nëntorit 1940, siç shihet parandiente sulmin e italo-gjermanëve në Jugosllavi dhe rolin që mund të merrnin forcat nacionaliste shqiptare në këtë çast duke u solidarizuar me shqiptarët e shtypur nga serbët.

Në qëndrimin ndaj pushtuesit patën rolin e vet edhe rrethanat sociale, në të cilat jetonin shqiptarët në krahina të ndryshme, traditat familjare të mëparshme në momente kyçe të historisë kombëtare. Nuk duhet harruar që tek shqiptarët, për pozicionimin ndaj pushtuesit ndikoi dhe politika e Italisë për të ngacmuar e inkurajuar tek ata aspiratën e bashkimit kombëtar. Me këtë kishte për qëllim të neutralizonte qëndresën e shqiptarëve ndaj pushtuesit.

Në këtë shtrat trajtimi të raporteve të pushtuesit italian ndaj shqiptarëve do të gjejnë shpjegimin e vet dhe qëndrimet e Litajve gjatë pushtimit italian të Shqipërisë. Këto qëndrime ndryshuan në procesin historik, në përputhje me detyrat që shtronte koha.

Në kuadrin e planeve për sulmin kundër Jugosllavisë në prill të vitit 1941 si dhe të nevojës për t’i bërë ballë sulmeve të çetave nacionaliste në Shqipëri, u krijuan repartet e milicisë shqiptare. Këto formacione u vunë në dispozicion të qeverisë shqiptare. Ato do të shërbenin për t’iu kundërvënë çetave, të cilat ishin

¹⁶ *Po aty*, F. VII, M. 347, POV. J.B. Br.13, 1940 g. – Skopje.

¹⁷ *Po aty*, F. VII, Br. 228, 1940 g. Skopje.

¹⁸ *Po aty*, F. VII, Br. 3800, 1940 gd. Skopje.

pothuajse tërësisht nacionaliste. Sipas vlerësimeve të Komandës së Lartë të Trupave italiane në Shqipëri, çetat nacionaliste arrinin në 5000-6000 vetë¹⁹.

Për këtë qëllim qeveria e M. Krujës kishte autorizuar Zyber Litën të rekrutonte milicë nga Luma. Me ta do të operonte në këtë rajon “kundër çdo elementi që do të prishte rendin”²⁰. Me gradën e n/toger ai bënte pjesë në krye të 150 milicëve, që siç ka pohuar vetë para gjyqit ushtarak të Divizionit I, “nuk kam pasur asnjë rast që të përpiqem me forca që luftonin fashizmin”²¹.

Forcat e milicisë së Gjon Marka Gjonit, në prill të vitit 1942 u dërguan të kryenin një operacion të gjerë kundra Muharrem Bajraktarit, në Lumë. Ata dogjën shtëpitë e 12 familjeve, pjesëtarët e të cilëve u arrestuan. Pas operacionit në Lumë u organizua një ndjekje nga ana e milicisë fashiste të elementëve kundërshtarë të pushtimit, nën komandën e majorëve Geloso, Ndrec Bajraktari, Kapiten Zyber Litës, toger Gjergj Vatës, n/toger Gani Myftar Bajraktarit dhe Ramadan Bajramit²².

Muharrem Bajraktari pas mbledhjeve që organizoi në Ujmisht, Vilë e Kalis, vendosi që të luftohej kundër forcave të operacionit, duke ngarkuar për këtë qëllim Zenel Litën, Selim Nokën, Xhumali Mehdin në lumin Velshica. Ndërsa vetë me Zylfi Maliqin e Myftar Ahmetin me sulmue Bicajt²³.

Me anën e operacionit në Lumë Gjon Marka Gjoni, kishte qëllim, veç të tjerash, të “vriste me shumë ustallëk Muharrem Bajraktarin, duke përdorur për këtë qëllim ndonjë hasëm ose kundërshtar naiv”. Pas operacionit Muharremi shkoi në Kosovë, ku u përball me një “ambient të ftohtë” për shkak të propagandës që kishte bërë qeveria kundër tij, sipas së cilës, ai kishte ardhë të merrej vesht me Mihajloviçin me shit Kosovë... (!) Këtë propagandë të qeverisë për Muharremin dhe nacionalistë të tjerë në krahinën e Lumës e të Kukësit e përforcuan dhe komunistët më vonë.

Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë pati ndikimin e vet, në qëndrimin e mjaft elementeve nacionalistë dhe në tërësi tek banorët e Veriut. Ajo situatë shkaktoi një farë indiferentizmi dhe hezitimi të shqiptarëve për veprimet e para të kryera nga italianët.

Popullsia e këtyre zonave kufitare me Kosovën, e kishin përjetuar disa herë me radhë dhunën e pushtimit serb. Ndaj bashkimin e Kosovës me Shqipërinë e përjetuan si një shans historik që u jepej shqiptarëve për ta shfrytëzuar me mjeshtëri, për t’u ndarë përfundimisht nga pushtuesi serb.

¹⁹ *US. SMEI, Diario Storico, B. 970, Relazione del CSTA del 4 settembre 1942.*

²⁰ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 202, viti 1944, dos. 73, fl. 4-6. Procesverbal i gjyqit ushtarak të Divizionit I të UNÇSH, mbajtur në Peshkopi më 6 shtator 1944.*

²¹ *Po aty.*

²² *Promemorje e Bajram Bajraktarit, f. 10.*

²³ *Po aty, f. 8.*

Zhvillimi i një veprimtarie të përbashkët administrative, ekonomike, arsimore, kulturore pothuajse në të gjitha trevat etnike shqiptare, pa dyshim ngjalli shpresë e optimizëm tek shumë shqiptarë në zgjidhjen e çështjes kombëtare. Prandaj, ndonjëri ndoshta i entuziazmuar nga kjo situatë e krijuar, pas bashkimit të Kosovës me Shqipërinë e të krijimit të Shqipërisë Etnike, krijoi mendimin se Italia, me praninë e saj i dha një shtytje çështjes shqiptare.

Megjithatë, nga radhët e familjes Litaj dolën shumë anëtarë si të arratisur politikë që kërkoheshin nga regjimi i kohës. Ndër 163 të arratisurit politikë sipas listës së qarkut të Prefekturës së Kosovës, të datës 23 korrik 1943²⁴, përmenden si të tillë edhe 7 anëtarë nga fisi Litaj. Ata ishin: Isuf Lita, Lan Dalip Lita, Nexhip Mislum Lita, Riza Iljaz Lita, Ismail Lita, Rushit Ali Lita, Xhaferr Ali Lita. Në të njëjtën listë të të arratisurve politikë përmenden dhe emrat e Muharrem Bajraktarit, Shaban Haxhisë, Ramë Mujës, Veli Nimanit etj.

Nga 61 delegatët pjesëmarrës të Kuvendit të Lurës zhvilluar më 27 gusht 1943 ishte dhe Zenel Lita (nga Ploshtani, Kalaja e Dodës). Midis atyre nacionalistëve përmendeshin: Fiqiri Dine, Muharrem Bajraktari, Cen Elezi, Abaz Kupi, Hysni Dema, Myftar Kaloshi, Aqif Lleshi, Sul Kurti, Bilal Kola, Sali Llani, Murat Basha, Dyle Allamani, Isuf, Çela, Isuf Selmani, Cen Lezi, Faik Shehu, Dervish Lusha, Haziz Kaloshi etj.²⁵

Për dimensionin nacionalist të Litajve dëshmojnë edhe anëtarë të Misionit Britanik që vepruan në Veri, në përpjekje për të realizuar bashkëpunimin e forcave politike shqiptare. “Kur gjermanët erdhën në Sllovë dhe dogjën shtëpinë e familjes Ndreu, Kempit dhe Simkoxi e gjithë të tjerët gjetën strehim në familjen Lita dhe nga këtu u udhëhoqën drejt Ujmishtit, ku P. Kemp u takua me Muharrem Bajraktarin”²⁶.

Në VL të Shqipërisë ku ushtronin misionin e vet oficerët britanikë, sipas gjykimit të R. Hibbertit, ndikimi britanik ushtrohej tek Familja Ndreu me Cen Elezin në krye, lidhjet, me të cilin, realizoheshin me anë të Xhelalit (Ndreu – M.D.)

Ndikimi britanik ushtrohej tek familja Lita me Osman Litën në krye, zona e të cilit ishte më në veri se ajo Ndreu. Më tej, drejt Veriut, ishte Muharrem Bajraktari. “Ai përbënte materialin më premtues nga të gjithë për rezistencën”²⁷.

Në vështrimin e oficerëve britanikë që vepronin tek figurat nacionaliste me ndikim që nga Dibra e deri në Lumë, nuk ishte vështirë të konstatohej edhe

²⁴ *AQSh*, Fondi 154, viti 1943, dos. 81, fl. 88-89. Lista e të arratisurve të rajonit të qarkut – Prefektura Kosovë, 23.VII.1943.

²⁵ Uran Butka, *Ringjallje*, Tiranë: 1995.

²⁶ Reginal Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993, f. 120.

²⁷ *Po aty*, f. 149.

profilizimi disi i veçantë që kishin mbi familjen Lita, sa i përket preferencës që duhej të kishin aleatët për ta. “Në krahinën e Litajve, siç shpreheshin R. Hibbert dhe Majkëll Lis, iu desh të dëgjonin leksione këmbëngulëse nga Sherif Lita dhe djemtë e Cen Elezit. “Xhaferr Lita pohonte se, Litajt duhej të vështroheshin si organizatorët më të mirë të mundshëm për rezistencën nacionale, por natyrisht ata do të kishin nevojë për sasi të konsiderueshme florinjsh që të fitonin dhe të mbanin një numër pasuesish të armatosur”²⁸. Pati edhe raste të presionit mbi oficerët britanikë me forca të drejtuar nga pjesëtarë të familjes Lita, me qëllim për t’i trembur dhe për t’i bërë me qenë më të kujdesshëm në lidhjet me partizanët²⁹.

Si përfundim mund të themi se forca e nacionalistëve të Lumës mund të rritej mjaft, po të arrihej të sheshoheshin disa kontradikta e zili që ekzistonin midis Litajve e Muharrem Bajraktarit dhe kjo për interesa kombëtare³⁰.

Lufta civile që kishin filluar forcat komuniste kundër nacionalistëve shqiptarë e bënte të domosdoshëm bashkëpunimin e fuqishëm të tyre me njëritjetrin. Humbjet e tyre mund të ishin më të ridimensionueshme dhe rezultatet e përpjekjeve për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare mund të kishin qenë më të suksesshme. Kalvarit të vuajtjeve të nacionalistëve shqiptarë, pas vendosjes së regjimit komunist, nuk i shpëtoi as familja e njohur Lita e Kalasë së Dodës.

²⁸ *Po aty*, f. 160.

²⁹ *Po aty*, f. 160.

³⁰ Shefqet Hoxha, *Muharrem Bajraktari e misionet britanike (1943-1944)*, Tiranë: 2000, f. 40-41.